

TERMAT E REFERENCES Kërkesë për shërbime Trajnimi

Pozicioni: Trajnues

Autoriteti kontraktues: Projekte Vullnetare Ndërkombëtare (PVN)

Kohëzgjatja: 3 ditë për ditët e trajnimit

Datat: 27 – 29 Janar 2022

Vendndodhja: Tiranë, Shqipëri

1. Background rreth projektit dhe studimit

Vullnetarizmi është një forcë sociale, dinamike, unifikuese dhe e fuqishme për komunitetin e njëkohësisht një aktivitet, filozofia e të cilit në Shqipëri është ende në zhvillim. Prej vitit 2016 Shqipëria ka një Ligj për Vullnetarizmin (Ligji 45/2016), i cili në fakt ka sjellë një efekt të kundërt me atë që pritej, duke u bërë kështu barrierë për organizatat e shoqërisë civile për shkak se është i fokusuar vetëm tek vullnetarizmi i strukturuar dhe lë jashtë çdo formë tjetër të vullnetarizmit. Ligji u ngarkon organizatorëve të vullnetarizmit barrën e pajisjes me siguracion të vullnetarëve, një barrë ekonomike e cila është e papërballueshme të paktën nga OSHC-të. Aktet nën ligjore të parashikuara nga ky ligj u aprovuan vetëm në vitin 2018 (Regjistri i Kontratave të Vullnetarizmit dhe Libreza e Vullnetarit) dhe 2019 (Kodi i Etikës). Disa vite pas aprovimit të Ligjit 45, një pjesë e madhe e OSHC-ve në vend ende nuk kanë informacione konkrete nëse institucionet ligjzbatuese (përkatese për zbatimin e Ligjit 45) kanë ndërmarrë masa koordinimi dhe implementimi për këtë ligj; nuk janë të informuara që Ligji u vë atyre detyrimin e pagesës së siguracionit të çdo vullnetari; që duhet të mbajnë një regjistër për vullnetarë apo që çdo vullnetarë duhet të pajiset me një Librezë pranë AKPA, etj.

Projekti “Vullnetarizmi pikëAL”, ka për qëllim krijimin e një mjedisi mundësues shumë dimensional ku vullnetarizmi inkurajohet, mbështetet, njihet si mekanizëm kyç për nxitjen e qytetarisë aktive, solidaritetit dhe kohezionit social në Shqipëri.

Objektivat e projektit:

1. Të identifikojë strukturat egzistuese, nevojat dhe sfidat mbi vullnetarizmin në nivel kombëtar duke eksploruar potencialin e bashkëpunimeve ndër-sektorale që mbështesin kërkitë të reja cilësore dhe sasore dhe të ofrojë alternativa funksionale në sektorin e vullnetarizmit;
2. Të advokojë dhe llojojë në nivel institucional përmes një procesi pune gjithëpërfshirës midis shoqërisë civile dhe qeverisjes vendore, për të përmirësuar kuadrin ligjor egzistues të vullnetarizmit, duke sugjeruar modele dhe qasje fleksibël;
3. Të krijojë struktura të qëndrueshme ndërvepruese midis aktorëve të interesuar për bashkëpunim, partneritete dhe zhvillimin e modeleve gjithëpërfshirëse të vullnetarizmit në nivel kombëtar nëpërmjet përdorimit të burimeve dixhitale innovative;

2. Qëllimi dhe objektivat e trajnimit

Ky trajnim synon rritjen e kapaciteteve të organizatave të ndryshme të shoqërisë civile, në ciklin e menaxhimit të strukturuar të vullnetarëve. Pjesëmarrësit e organizatave do të kenë mundësi të mësojnë dhe praktikojnë ciklin e menaxhimit të vullnetarëve hap pas hapi, detyrat/përgjegjësitë e vullnetarëve dhe ofruesve të vullnetarizmit, por edhe të ndërtojnë plane konkrete për programe vullnetare lokale të cilat do t'i përdorin në fazën e pilotimit në vijim.

Gjithashtu pas trajnimit 8 organizata do të kenë mundësi të jenë pjesë e mentorimit për përdorimin e platformës “Vullnetarizmi.al” si dhe praktikimin e protokollit të standarteve.

Objektivat:

- Rritja e njohurive dhe kapaciteteve të 16 kordinatorve nga 8 organizata të shoqërisë civile rreth Ciklit të Menaxhimit të Vullnetarëve;
- Rritja e njohurive se si të ndërtojnë plane konkrete për programe vullnetare;
- Të njihen me të drejtat dhe detyrimet e vullnetarve dhe ofruesve të vullnetarizmit;
- Të inkurajohen në pilotimin platformës Vullnetarizmi.al dhe të jenë pjesë aktive e promovimit dhe nxitjes së vullnetarizmit në të ardhmen;

3. Metodologjia e Trajnimit

Trajnimi do të jetë i bazuar në metoda të edukimit jo formal kombinuar me atë formal. Metodatat kryesore janë diskutime të lira, reflektime, punë në grupe, prezantime etj

4. Detyrat dhe background i trajnuesve

Në kuadër të këtij trajnimi do të kontraktohen 2 trajnues me eksperiencë dhe aftësi në organizimin e trajnimeve, vecanërisht në fushën e vullnetarizmit dhe shoqërisë civile, duke patur bashkëpunim të ngushtë sëbashku.

Kriteret që trajnuesit duhet të plotësojë

- Të këtë përfunduar studimet në një nga këto fusha: Shkenca Sociale dhe/ose Të drejtat e Njeriut, Demokraci, etj;
- Jo më pak se 5 vite eksperiencë në organizimin dhe facilitim trajnimesh;
- Njohuri dhe experiencë në fushën e vullnetarizmit, organizatave të shoqërisë civile, solidaritetin, të rinjtë dhe/ose në fusha të ngjashme;
- Njohuri dhe experiencë në përdorimin e metodave të edukimit jo formal;

Përgjegjësit e trajnuesit

- Të përgatisë materialet për trajnimin me shoqërinë civile;

- Të përgatis metodologjin e trajnimit;
- Të përgatisë programin e trajnimit me modulet përkatëse;
- Të marrë pjesë dhe të lehtësoj trajnimin në të 3 ditët sëbashku me trajnuesin/en tjetër;
- Të përgatisë timesheet dhe një raport të shkurtër së bashku me trajnerin/en tjetër për tre ditët e shërbimit;

5. Buxheti dhe modalitetet e pagesës

- Vlera totale e kontratës është 300 CHF bruto;
- 3 ditë x 100 CHF;
- Taksat (15 %) do të zbriten nga totali;
- Kontrata do të bëhet në ALL me kursin e percaktuar nga Leviz Albania 111.5;
- Pagesa do të kryhet pas përfundimit me sukses dhe ekzekutimit të gjithë detyrave në një pagesë të vetme;

6. Afati kohorë për realizimin e projektit

Numëri i ditëve të shërbimit për ekspertët:

- 3 ditë

7. Evidencat dhe dokumentat mbështetës

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë një mail më Subjekt: *Aplikim për Trajnues me Shoqërin Civile*, dhe bashkëngjisë këto dokumenta:

- ID
- CV

deri me datë 10 Janar 2022 në adresën info@pvnalbania.org